



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Hapet shqyrtimi publik – Harta Zonale e Komunës së Podujevës 2021-2029

Bazuar në nenin 4, neni 11 dhe neni 20 të Ligjit për Planifikim Hapësinor 04/L-174, nenit 5, 6, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat e pjesëmarrjes së publikut në planifikimin hapësinor, Vendimin e Kuvendit të Komunës së Podujevës Nr. 01-350/05-0085317/21, Dt. 27.09.2021 për vënien në shqyrtim publik të Hartës Zonale të Komunës së Podujevës, Komuna e Podujevës – Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit shpallë:

NJOFTIM PËR HAPJEN E SHQYRTIMIT PUBLIK

Projekt dokumenti – Harta Zonale e Komunës së Podujevës 2021-2029

Komuna e Podujevës fton qytetarët, sektorin publik dhe privat, ekspertët, dhe të gjithë të interesuarit që të marrin pjesë në procesin e Shqyrtimit Publik të Projekt dokumentit – Harta Zonale e Komunës së Podujevës 2021-2029.

Shqyrtimi publik Projekt dokumenti – Harta Zonale e Komunës së Podujevës 2021-2029 do të zhvillohet nga data 20 shtator deri më 19 nëntor, çdo ditë pune nga ora 10 deri në orën 12, në sallën e Kuvendit të Komunës së Podujevës në objektin e Ri Katin përdhësë faqen zyrtare të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>.

Kundërshtimet, komentet apo sugjerimet në Projekt dokumentin – Harta Zonale e Komunës së Podujevës 2021-2029 mund të paraqiten në formë të shkruar gjatë periudhës së shqyrtimit publik deri më 19 nëntor 2021 dhe i adresohen Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ndërtesa e komunës, kati I-rë, zyra 20 ose në emailin zyrtar: [masar.qitaku @rks-gov.net](mailto:masar.qitaku@rks-gov.net).

Materiali në kopje fizike dhe sqarimet nga stafi do të zhvillohen në Ndërtesën e Komunës së Podujevës, në katin e I-rë, zyra 20, ndërsa kundërshtimet, komentet, sugjerimet dhe propozimet mund të shkruhen në librin e prezentuar në periudhën dhe orarin ditor të përcaktuar sipas këtij njoftimi.

Draft-dokumentin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës 2021-2029 ka kaluar të gjitha fazat e paraparë me ligjet në fuqi deri në fazën e shqyrtimit publik dhe paraqet rezultatin e një pune të përbashkët të profesionistëve të fushave të ndryshme dhe përfaqësuesve nga sektorët relevantë të Komunës së Podujevës dhe Qeverisë së Kosovës.

Gjatë periudhës së shqyrtimit publik, do të organizohet takime me profesionistët, grupet e interesit, përfaqësuesit e institucioneve etj.

Prezantimet publike të draft-dokumentit – Harta Zonale 2021-2029 do të mbahen sipas rregullave të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, me aktivitetet e prezantuara si në vijim:

Aktiviteti	Vendi	Data
Hapja e Shqyrtimit Publik	Salla e KK (ndërtesa e re)	20.10.2021
Takim ditor me qytetarët – Vendosja e Librit për kërkesat në hyrje të Komunës	Komunë – <i>One Stop Shop</i>	26-29.2021
Takim me komunitetin e arkitekteve dhe Inxhinierëve	Salla e KK (ndërtesa e re)	28.10.2021
Takim me përfaqësuesit e biznesit dhe shoqërisë civile	Salla e KK (ndërtesa e re)	30.10.2021
Takim me qytetarët dhe përfaqësuesit e Bashkësive lokale dhe të fshatrave	Salla e KK (ndërtesa e re)	21.10.2021
Takim me përfaqësuesit e kompanive të ndërtimit	Salla e KK (ndërtesa e re)	01.11.2021
Pranimi kërkesave nëpërmjet email adresave	Adresa zyrtare e Komunës	20 tetor-12
Takim me Kompanitë publike (Hidroregjioni, Ekoregjioni, Infrakosi etj.)	Salla e KK (ndërtesa e re)	03.11.2021
Takim me Ministrinë relevante	Prishtinë	05.11.2021
Takim me ekspertët e partive politike	Salla e KK (ndërtesa e re)	08.11.2021
Takime me banorët e lagjeve të organizuar sipas kërkesave të tyre (si takim përmbyllëse)	Salla e KK (ndërtesa e re)	15.11.2021

Qëllimi i organizimit të shqyrtimit publik, si pjesë e procesit të hartimit të Hartës Zonale të Komunës, është që të pranohet dhe vlerësohen komentet të cilat shërbejnë për ngritjen e cilësisë së dokumentit, para dorëzimit të tij për miratimin përfundimtar në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe në Kuvendin e Komunës.

Draft-dokumenti i Hartës Zonale të Komunës së Podujevës 2021-2029 dhe Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Hartës Zonale të Komunës së Podujevës (VSM) është i publikuar në Web –faqen: <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>, si dhe është e publikuar në korridorin e përdhësës të ndërtesës së Komunës.

Njoftimi për Shqyrtim Publik vendoset në mjetet të informimit dhe në Web –faqen e Komunës së Podujevës.